

V E N D I M
Nr. 450, datë 17.8.2000

**PËR PRIVATIZIMIN E KUOTAVE SHTETËRORE NË SHOQËRINË DV-ALBTURIST
HOTELIERS, SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare" dhe nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Privatizimin e kuotave të ortakëve shtetërorë Albturizëm, Banka e Kursimeve, INSIG, në shoqërinë e përbashkët DV-ALBTURIST HOTELIERS, sh.p.k.

2. Forma, formula dhe procedura e privatizimit të kuotave të ortakëve shtetërorë, në shoqërinë DV-ALBTURIST HOTELIERS, sh.p.k., të përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave, Komiteti i Zhvillimit të Turizmit dhe ortakët shtetërorë, në shoqërinë e përbashkët DV-ALBTURIST HOTELIERS, sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta